



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 3.3.2025

Nr: 231

Ora: 15:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE PARTIA “KOALICIONI EUROATLANTIK”, ME KRYETAR Z. ENDRI HASA, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

Sot më datë 3.3.2025 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1236 Prot., datë 24.02.2025, me:

- Kërkues:** Partia politike Partia “Koalicioni Euroatlantik”, me kryetar Z. Endri Hasa
- Objekti:** Shqyrtimin e kërkesës së partisë politike Partia “Koalicioni Euroatlantik” për regjistrim si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025
- Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend.

Partia “Koalicioni Euroatlantik”, nëpërmjet Kryetarit Z. Endri Hasa, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025, administruar me nr. 1236 Prot., datë 24.02.2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- Vendimin e shkurtuar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, i shpallur në datën 14.02.2025 dhe nuk ka marrë formë të prerë;
- Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Data: 3.3.2025 Nr: 231
Ora: 15:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike Partia “Koalicioni Euroatlantik”, me Kryetar Z. Endri Hasa, për regjistrim si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”.

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është Partia “Koalicioni Euroatlantik” me shkronja nistore “KEA”, me adresë Rruga “Donika Kastrioti”, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Endri Hasa, me adresë: Rruga “Donika Kastrioti”, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Zj. Jonida Bardhi, me adresë: Rruga “Donika Kastrioti”, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Ibrahim Sako, me adresë: Rruga “Donika Kastrioti”, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “Koalicioni Euroatlantik”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 64, pika 2, shkronja “a” e Kodit Zgjedhor, parashikon se partia politike për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor duhet të paraqesë një vërtetim që vërteton se partia është e regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë

Me shkresën nr. 1236/1 Prot., datë 03.03.2025 z. Endri Hasa ka depozituar pranë KQZ-së, Vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, datë 03.03.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia “Koalicioni Euroatlantik” me shkronja nistore “KEA”, me kryetar Z. Endri Hasa, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga Partia “Koalicioni Euroatlantik” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.01.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

VENDOS:

1. Regjistrimin e partisë politike Partia “Koalicioni Euroatlantik”, me Kryetar Z. Endri Hasa, me shkronjat nistore “KEA”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI